



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d si dhe neni 14 paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më datën 02.12.2016, merr këtë

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VARREZAT E KOMUNITETIT
PROTESTANT

I.

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit të varrezave në lagjen “Sofalia”, Prishtinë.

II.

Lokacioni nga pika I e këtij vendimi, caktohet në lagjen “Sofalia”, Komuna e Prishtinës, Zona Kadastrale Prishtinë, në pjesën e parcelës kadastrale me nr. 2580-0, dhe në parcelën kadastrale me nr. 2581-0, në pronësi të Komunës, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4,716 m² (47 ari).

III.

Para fillimit të përshtatjes së lokacionit për ndërtimin e varrezave duhet të mirret Pëlqim për Ndërtim Peizashi nga Drejtoria e Urbanizmit.

IV.

Kriteret të cilat duhet të përmbushen me caktimin e këtij lokacioni janë:

1. Përgjatë kufirit të parcelës private me nr.2582-3 duhet të sigurohet një tampon mbrojtës (gjelbërim izolues) me gjerësi prej 10m.
2. Brenda tamponit gjelbërues (gjelbërim izolues) nuk lejohet ndërtimi i varrezave,
3. Ky tampon duhet të mbillet me gjelbërim të lartë (Pisha).
4. Gjelbërim i lartë ekzistuese (pishat) duhet të mbrohen.

V.

Pa plotësimin e kriterëve në pikën IV të këtij Vendimi, ky lokacion nuk mund të filloj të përdoret për varreza.

VI.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtoria e Urbanizmit dhe Drejtoria e Kadastrit.

VII.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë skicat e lokacionit të cekur në pikën II të këtij Vendimi.

VIII.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.nr. 353-295934, më 06.12.2016

KRYESUESI I KUVENDIT

Halim Halimi, jur. i dipl.

ARSYETIM

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm - Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr.01-353-222183 dt. 01.09.2016, përmes Kabinetit të Kryetarit të K.K.Prishtinës, nga Kisha Protestante Ungjillore të Kosovës për caktimin e lokacionit të varrezave për Komunitetin Protestant.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartë cekur nga Kisha Protestante Ungjillore të Kosovës dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj Drejtorie dhe përfaqësuesit e Kishës Protestante është identifikuar lokacionin për varreza i cili gjendet në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 031-247790 të dt. 04.10.2016, gjegjësisht brenda Planit Zhvillimor Urban, lokacioni i propozuar shtrihet në parcelat kadastrale me nr. 2581-0 ZK-Prishtinë dhe në një pjesë të parcelës me nr. 2580-0 ZK-Prishtinë në pronësi - pronë shoqërore K.K Prishtinë.

Lokacioni i propozuar për varreza ka sipërfaqe të përgjithshme prej 4,716m² (47 ari) .

Sipas Planit Rregullues "Sofalia" dhe Planit Zhvillimor Urban, kjo parcelë është e destinuar për gjelbërim të ulët, dhe si e tillë në aspekt të planifikimit urban nuk paraqet ndonjë pengës për caktimin e lokacionit sipas kërkesës së Komunitetit Protestant.

Bazuar në gjendjen faktike konstatojmë se parcela me nr.2581-0 ZK - Prishtinë tangon me parcelën me nr.2582-3 ZK- Prishtinë - pronë private, e destinuar sipas Planit Zhvillimor Urban si zone me destinim për banim individual.